



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 79, datë 12.12.2007**

**“PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KËSHILLIMOR TË STABILITETIT FINANCIAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, të nenit 9, paragrafi 9 i Statutit të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 100, datë 19.12.2000, i ndryshuar; të rregullores “Mbi rregullat proceduriale të Bankës së Shqipërisë”, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 16.05.2001, me propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë krijimin e “Komitetit Këshillimor të Stabilitetit Financiar”, si organ kolegjal këshillimor për çështjet e stabilitetit financiar me afat veprimtarie të pakufizuar, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar në pikën 2, të këtij vendimi, si dhe të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Të miratojë rregulloren “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit Këshillimor të Stabilitetit Financiar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen të gjitha departamentet e Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 mars 2008.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**

# **BANKA E SHQIPËRISË KËSHILLI MBIKËQYRËS**

## **RREGULLORE**

### **“Mbi ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KËSHILLIMOR TË STABILITETIT FINANCIAR”**

#### **Kapitulli I**

#### **Të përgjithshme**

##### **Neni 1**

##### **Objekti i udhëzimit**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Komitetit Këshillimor të Stabilitetit Financiar.

##### **Neni 2**

##### **Baza ligjore**

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 43, shkronja “c” dhe nenit 53 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- b) nenit 9, pika 9.9 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 100, datë 19.12.2000, i ndryshuar;
- c) rregullores mbi “Rregullat proceduriale të Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 16.05.2001.

2. Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar, krijohet dhe funksionon në përputhje dhe në zbatim të:

- a) nenit 9, pikave 9.3 dhe 9.9, të Statutit të Bankës së Shqipërisë të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 100, datë 19.12.2000, i ndryshuar;
- b) neneve 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të rregullores “Mbi rregullat proceduriale të Bankës së Shqipërisë”, të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 16.05.2001.

##### **Neni 3**

##### **Përkufizime**

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) **“Banka”** - është Banka e Shqipërisë;

- b) **“Komiteti”** - është Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar. Ky term do të nënkuptojë edhe anëtarët e Komitetit, në funksion të përdorimit në përmbajtjen e dispozitave të kësaj rregulloreje;
- c) **“DSF”** - është Departamenti i Stabilitetit Financiar në Bankë;
- d) **“DM”** - është Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankë;
- e) **“DSP”** - është Departamenti i Sistemeve të Pagesave në Bankë;
- f) **“DOM”** - është Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankë;
- g) **“DK”** - është Departamenti i Kërkimeve në Bankë;
- h) **“DS”** – është Departamenti i Statistikës në Bankë;
- i) **“DJ”** – është Departamenti Juridik në Bankë;
- j) **“AMF”** - është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- k) **“AK”** - është Autoriteti i Konkurrencës;
- l) **“ASD”** - është Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
- m) **“Mbledhja”** - është takimi i zakonshëm ose i jashtëzakonshëm i anëtarëve të Komitetit, i cili thërritet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;
- n) **“Dokumenti i votimit”** - është dokumenti ku sipas një formati të paracaktuar, evidentohet çështja për të cilën është votuar në mbledhjen e Komitetit, lista e votuesve, rezultati i votimit, qëndrimi i secilit votues dhe arsyet kryesore të këtij qëndrimi;
- o) **“Materialet e mbledhjes”** - janë tërësia e informacioneve, e të dhënave, e treguesve, e analizave, e dokumenteve, e propozimeve, të cilat paraqiten në mbledhjen e Komitetit nga ana e anëtarëve të tij.
- p) **“Konkluzionet e mbledhjes”** - janë qëndrimet e Komitetit, të cilat rezultojnë konsensuale ose mbizotërojnë gjatë diskutimeve në mbledhje, si edhe kërkesat ose propozimet që formulohen mbi bazën e tyre, për struktura të tjera brenda Bankës;
- q) **“Rreziqe kryesore”** - janë ato rreziqe të cilat, nëse materializohen, dëmtojnë rëndë stabilitetin e sistemit financiar në përgjithësi dhe përfaqësojnë një kosto të lartë administrimi;
- r) **“Rreziqe në monitorim”** - janë ato rreziqe që gjykohen që janë materiale, por mbi bazën e informacioneve dhe të vlerësimeve ekzistuese nuk konsiderohen të së njëjtës ashpërsi dhe kanë probabilitet të ulët ndodhjeje, në krahasim me rreziqet kryesore.

## **Kapitulli II**

### **Qëllimi, funksionet, objektivat operacionale dhe detyrat e Komitetit për realizimin e tyre**

#### **Neni 4 Qëllimi i Komitetit**

Komiteti, nëpërmjet veprimtarisë së tij, ka si qëllim të përmirësojë në vazhdimësi cilësinë e analizës dhe të vendimmarrjes së Bankës nëpërmjet këshillimit të organeve drejtuese të saj, për çështje që lidhen me stabilitetin financiar.

#### **Neni 5 Funksionet e Komitetit**

Komiteti, në funksion të qëllimit të tij sipas nenit 4, ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) shqyrton dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e Bankës në lidhje me stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar, gjendjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe veprimet e Bankës e të autoriteteve të tjera për ruajtjen e tij, nivelet e rrezikut në sistemin financiar dhe masat për administrimin e tij;

- b) formulon rekomandime për Këshillin Mbikëqyres dhe për administratorët e Bankës, për çështje të stabilitetit financiar dhe veprime të caktuara në këtë drejtim, nëpërmjet paraqitjes së konkluzioneve të mbledhjeve të tij; si edhe
- c) shërben si një instrument për të harmonizuar rolin dhe veprimet e Bankës në këtë kuadër, me institucione të tjera.

## **Neni 6**

### **Objektivat operacionalë të Komitetit**

1. Për të realizuar funksionet e tij sipas nenit 5, Komiteti përcakton objektivat e tij operacionalë për vitin financiar.
2. Në çdo rast, por pa u kufizuar prej tyre, Komiteti përcakton këta objektiva operacionalë:
  - a) evidenton në një dokument të veçantë, rreziqet kryesore për stabilitetin e sistemit financiar shqiptar, vlerëson rregullisht nivelin e këtyre rreziqeve (individualisht dhe të marrë së bashku) dhe përditëson dokumentin, mbështetur në analizën e zhvillimeve në treg;
  - b) propozon në Këshillin Mbikëqyrës veprimet e nevojshme për trajtimin e rreziqeve kryesore dhe vlerëson rregullisht efektin e tyre;
  - c) mbikëqyr procesin e hartimit të Raportit të Stabilitetit Financiar dhe të çdo dokumenti tjetër të rëndësishëm në këtë fushë dhe autorizon paraqitjen e tij në Këshillin Mbikëqyrës nga departamenti përkatës i Bankës.

## **Neni 7**

### **Detyrat e Komitetit për realizimin e objektivave operacionalë**

1. Komiteti miraton një dokument ku përcakton listën e materialeve që shqyrton në mbledhjet e tij, anëtarin përgjegjës për përgatitjen e secilit prej tyre, frekuencën e paraqitjes dhe përmbajtjen e kërkuar, si edhe paraqitjen ose jo të tyre në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës. Ky dokument rishikohet në mënyre periodike.
2. Për realizimin e tërësisë së objektivave të tij operacionalë, Komiteti:
  - a) ndjek zhvillimet në tregjet financiare dhe synon të tërheqë opinionin e përfaqësuesve të industrisë financiare dhe të ekspertëve të jashtëm, rreth tyre;
  - b) nxit nismën individuale dhe punën në grup të anëtarëve të Komitetit dhe të ekspertëve të Bankës ose iu cakton atyre detyra, për analizimin e hollësishëm të dukurive me interes për trajtimin e çështjeve të stabilitetit financiar;
  - c) realizon një proces të rregullt komunikimi dhe mbikëqyrjeje të ecurisë së nismave dhe të zbatimit të detyrave të përshkruara në pikën 2, shkronja " b";
  - d) synon, një diskutim dhe gjykim kolektiv, profesional dhe të hapur, në lidhje me çështjet që shqyrton;
  - e) paraqet konkluzionet e tij në dokumente të ndryshme që publikohen nga Banka në përputhje me rregullat dhe procedurat e botimeve dhe të publikimeve të Bankës;
  - f) propozon përgatitjen ose rishikimin e politikave dhe të praktikave të ndryshme të Bankës, të nevojshme për ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe nxit diskutimin për përmirësimin e dokumenteve dhe të praktikave të ngjashme në nivel ndër-institucional.

3. Për të realizuar objektivin e tij sipas nenit 6, pika 2, shkronja "a", Komiteti:

- a) diskuton çështjet që i dedikohen kryesisht vlerësimit të rrezikut, sipas nenit 10, pikës "a";
- b) zhvillon mbledhje të tjera, të jashtëzakonshme, për shqyrtimin e detajuar të elementeve të veçantë të vlerësimit të rrezikut;
- c) shqyrton materiale mbi gjendjen e sistemit financiar dhe të cilat vlerësojnë rreziqet kryesore, të përcaktuara sipas procedurës në pikën 1 të këtij neni;
- d) kërkon kuantifikimin e vlerës së këtyre rreziqeve në këto materiale nëpërmjet supozimit të skenarëve të ndryshëm, analizës *stress-test* si edhe shqyrtimit të treguesve të agreguar të rrezikut, siç janë ato që nxirren nga zhvillimet e çmimeve të asetëve financiare;
- e) shqyrton vlerësimin e ekspertëve në lidhje me kërcënimet e ndryshme dhe vendos nëse ato duhet të përfshihen në dokumentin e rreziqeve kryesore ose të përfshihen në listën e rreziqeve në monitorim;
- f) vlerëson nëse janë shfaqur rreziqe të reja të cilat duhen analizuar me hollësisht nga personeli i specializuar (ekspertët) si dhe nëse ndonjë prej rreziqeve kryesore paraqet një rëndësi më të ulët dhe vendos nëse ky rrezik duhet të eliminohet nga lista e rreziqeve kryesore.
- g) vlerëson mënyrën e ndikimit të zhvillimeve gjatë periudhës së fundit mbi rreziqet kryesore të evidentuara në dokumentin e Komitetit, si edhe mbi ato që janë në monitorim.

4. Për realizimin e objektivit sipas nenit 6, pika 2, shkronja "b", Komiteti:

- a) diskuton çështjet që i dedikohen kryesisht zbutjes së rrezikut, sipas nenit 10, pikës "b";
- b) zhvillon mbledhje të tjera, të jashtëzakonshme, për përcaktimin dhe vlerësimin e detajuar të masave për zbutjen e rrezikut;
- c) vlerëson rregullisht në vijim të çdo ndryshimi në vlerësimin e rreziqeve, duke dhënë rekomandime përkatëse, përshtatshmërinë e programeve (të politikave, të procedurave dhe të praktikave) të Bankës për zbutjen e rreziqeve dhe planifikimin e administrimit të krizave;
- d) vlerëson nëse programet aktuale kërkojnë ndryshime në bazë të vlerësimit më të fundit të rreziqeve dhe përparimit në zbatimin e programeve;
- e) identifikon vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të programit dhe vendos në lidhje me përparësitë që do t'i jepen nismave të ndryshme për zgjidhjen e tyre;
- f) shqyrton nismat individuale, nëse anëtarët e Komitetit gjykojnë që ajo ka një rëndësi të veçantë. Diskutimet e detajuara të iniciativave individuale, i delegohen personelit të specializuar ose grupeve të posaçme të ekspertëve;
- g) vlerëson nëse Banka duhet të kërkojë veprime të përbashkëta me autoritete të tjera mbikëqyrëse të sistemit financiar ose me autoritete të huaja financiare, dhe propozon formën e kërkesës;
- h) synon harmonizimin e punës së Bankës me atë të autoriteteve të tjera në drejtim të zbutjes së rreziqeve.

5. Për realizimin e objektivit sipas nenit 6, pika 2, shkronja "c", Komiteti:

- a) diskuton çështjet që lidhen me këtë objektivi dhe drejton punën për përgatitjen e Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF), në të paktën tre mbledhje të jashtëzakonshme që zhvillohen gjatë procesit të hartimit të tij, sipas nenit 10 pikës "c";
- b) në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e cila zhvillohet të paktën 12 (dymbëdhjetë) javë përpara paraqitjes së raportit në mbledhjen e Këshillin

Mbikëqyrës, Komiteti diskuton, mbështetur mbi një material paraprak të DSF, çështjet kryesore që do të përfshihen në RSF,;

- c) në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet të paktën 4 (katër) javë përpara paraqitjes së raportit në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, Komiteti diskuton mbi një projekt të raportit, dhe jep rekomandimet përkatëse për personelin e DSF në mënyrë që në raport të shprehet në mënyrë të përshtatshme mendimi i Komitetit mbi rreziqet e stabilitetit financiar;
- d) së fundi, Komiteti mblidhet 2 (dy) javë përpara dorëzimit të dokumentit për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim që të kryejë ndryshimet e fundit të mundshme në projektraport, duke u përqendruar në mesazhet që përcillen në pjesën hyrëse të tij, si edhe të miratojë versionin përfundimtar të raportit që i përcillet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Mbikëqyrës të Bankës;
- e) vlerëson nëse duhet ndjekur një procedurë e ngjashme për shqyrtimin e dokumenteve të tjera të rëndësishme, në këtë drejtim.

### **Kapitulli III**

#### **Organizimi i Komitetit**

##### **Neni 8**

##### **Përbërja e Komitetit**

1. Komiteti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:
  - a) Guvernatori, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit;
  - b) Zëvendësguvernatori i Dytë, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Komitetit;
  - c) drejtori i DSF;
  - d) drejtori i DM;
  - e) drejtori i DSP;
  - f) drejtori i DOM;
  - g) drejtori i DK;
  - h) drejtori i DS dhe
  - i) drejtori i DJ.
2. Guvernatori përcakton me urdhër të veçantë anëtarët e Komitetit në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Në rastin kur Kryetari i Komitetit mungon ose është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendëskryetari merr dhe ushtron kompetencat e tij. Në mungesë edhe të Zëvendëskryetarit, Kryetari autorizon një nga anëtarët e tjerë të Komitetit për drejtimin e mbledhjes së tij.
4. Përveç sa parashikohet në pikën 3 të këtij neni, në rast se një nga anëtarët e përcaktuar në pikën 1 shkronjat "c" deri në "i", mungon ose është në pamundësi për të marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit, ai zëvendësohet në përputhje me rregullat procedurale të Bankës. Zëvendësuesit, i kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të zëvendësuar. Për çdo rast të tillë, anëtari i zëvendësuar si më lart, njofton drejtuesin e mbledhjes.
5. Çdo anëtar i Komitetit, mund të shoqërohet në mbledhje nga një nëpunës i zgjedhur prej tij, me pëlqimin paraprak të drejtuesit të mbledhjes. Nëpunësi shoqërues nuk të drejtë vote në mbledhjet e Komitetit.

6. Në rast se gjykohet e përshtatshme, në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote, përfaqësuesit e autorizuar të AMF, të ASD, të AK dhe të ndonjë institucioni tjetër që gjykohet i nevojshëm.

## **Neni 9**

### **Mbledhjet e Komitetit dhe thirrja e tyre**

1. Mbledhjet e Komitetit zhvillohen sipas një kalendari të miratuar prej tij, në përputhje me këtë nen.
2. Mbledhjet e Komitetit ndahen në:
  - a) të zakonshme, të cilat zakonisht zhvillohen në muajt shkurt, maj, korrik dhe nëntor;
  - b) të jashtëzakonshme, të cilat zhvillohen sipas nevojës.
3. Mbledhjet e Komitetit mund të jenë:
  - a) me pjesëmarrje të kufizuar, ku marrin pjesë vetëm anëtarët;
  - b) me pjesëmarrje të plotë, ku marrin pjesë edhe persona të përcaktuar sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 8, të kësaj rregulloreje.
4. Mbledhja e Komitetit thërritet nga:
  - a) Kryetari i Komitetit, kryesisht ose me propozim të njërit prej anëtareve të Komitetit;
  - b) Zëvendëskryetari, sipas nenit 8, pika 3;
  - c) anëtari që është autorizuar të drejtojë mbledhjen e Komitetit, sipas nenit 8, pika 3.
5. Personi që thërret mbledhjen sipas pikës 4 të këtij neni, përcakton nëse mbledhja do të jetë me pjesëmarrje të kufizuar apo me pjesëmarrje të plotë, sipas pikës 3 të këtij neni. Kërkesa për thërritjen e mbledhjes së bashku me datën e zhvillimit, i drejtohet sekretarit të Komitetit, i cili njofton pjesëmarrësit për zhvillimin e saj.
6. Mbledhja e Komitetit realizohet vetëm nëse ajo thërritet sipas pikës 4 të këtij neni dhe mund të drejtohet sipas nenit 8, pika 3. Në rast të kundërt, realizimi i mbledhjes shtyhet për një datë tjetër të përshtatshme.

## **Neni 10**

### **Tematika e mbledhjes**

Në varësi të tematikës së mbledhjes, e cila lidhet me natyrën e çështjeve që shqyrtohen, me rëndësinë dhe me rregullsinë e trajtimit të tyre, si edhe me materialet që disponohen rreth tyre, mbledhjet e Komitetit mund të kategorizohen si vijon:

- a) për vlerësimin e rrezikut;
- b) për zbutjen e rrezikut; ose
- c) për përgatitjen e Raportit të Stabilitetit Financiar dhe të çdo dokumenti tjetër të rëndësishëm në fushën e stabilitetit financiar.

## **Neni 11**

### **Kompetencat e Kryetarit**

Kryetari i Komitetit ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) thërret ose autorizon Zëvendëskryetarin për të thërritur, mbledhjet e Komitetit sipas nenit 9, pika 4, shkronjat "a" dhe "b";
- b) përcakton nëse mbledhja do të jetë me pjesëmarrje të kufizuar ose të plotë, sipas nenit 9, pika 5;
- c) drejton mbledhjet e Komitetit ose autorizon një anëtar të drejtojë mbledhjen, në përputhje me nenin 8, pika 3;
- d) miraton pjesëmarrjen në mbledhje, të nëpunësve që shoqërojnë anëtarët e Komitetit, sipas nenit 8, pika 5 si dhe të përfaqësuesve të institucioneve të tjera, sipas nenit 8, pika 6;
- e) nënshkruan propozimet e Komitetit për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës dhe administratorët e saj;
- f) përcakton veprimet në lidhje me përdorimin e informacionit jopublik të Komitetit, sipas nenit 14;
- g) orienton në përgjithësi veprimtarinë e Komitetit, për realizimin e qëllimit dhe të objektivave të tij.

## **Neni 12**

### **Sekretari i Komitetit dhe detyrat e tij**

1. Sekretari i Komitetit caktohet nga Guvernatori me propozim të drejtorit të DSF. Sekretari nuk gëzon të drejtën e votës.
2. Sekretari njofton anëtarët e Komitetit për zhvillimin e mbledhjes, mbështetur në përcaktimet e nenit 9. Anëtarët njoftohen të paktën 10 ditë pune përpara datës së mbledhjes për mbledhjet e zakonshme, si dhe mbi temat e çështjeve dhe të materialeve kryesore që do të diskutohen, të shoqëruar sipas rastit me një përmbledhje të përmbajtjes së tyre. Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin e organizimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme sipas nenit 9, pika 2, shkronja "b", sekretari vepron sipas mundësive më të mira dhe në bazë të kohës që ka në dispozicion.
3. Çdo anëtar i Komitetit vë në dispozicion të sekretarit të paktën 5 dite pune përpara zhvillimit mbledhjes, materialet që do të paraqesë gjatë saj.
4. Sekretari vë në dispozicion të anëtarëve që do të marrin pjesë në mbledhje, të paktën 2 ditë pune përpara zhvillimit të saj, materialet që do të paraqiten. Në rastin e zhvillimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme sipas nenit 9, pika 2, shkronja "b", sekretari vë në dispozicion materialet e paraqitura sipas mundësive më të mira dhe në bazë të kohës në dispozicion.
5. Kryetari i Komitetit mund të autorizojë, kur kjo është e mundur, sekretarin të vërë paraprakisht në dispozicion të personave të përcaktuar në nenin 8 pika 6, materialet që do të paraqiten në mbledhje në një formë të përshtatshme.
6. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, sekretari mban me shkrim procesverbalin e mbledhjes, në të cilin evidentohen:

- a) lloji i mbledhjes, si edhe data dhe ora e zhvillimit të saj;
  - b) pjesëmarrësit në mbledhje dhe drejtuesi i saj;
  - c) çështjet që shqyrtohen dhe konfidencialiteti i tyre, të përcaktuara nga Komiteti;
  - d) lloji dhe burimi i materialeve që paraqiten në mbledhje për shqyrtim;
  - e) personat që diskutojnë dhe objekti i diskutimit të tyre;
  - f) propozimet që kalojnë për votim;
  - g) kryerja ose jo e votimit dhe rezultati i tij. Në rast votimi, sekretari përgatit dhe ruan gjithashtu dokumentin e votimit, i cili i bashkohet procesverbalit të mbledhjes;
  - h) konkluzionet e mbledhjes;
  - i) data e synuar e zhvillimit të mbledhjes së ardhshme.
7. Pas mbledhjes, sekretari kryen detyrat e mëposhtme:
- a) përgatit në 3 (tre) kopje, një dokument të veçantë me konkluzionet e arritura në mbledhjen e Komitetit dhe, pasi e nënshkruan atë, merr në dokument nënshkrimet e anëtarëve që morën pjesë në mbledhje;
  - b) mban dhe ruan një kopje të dokumentit të përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike;
  - c) i dërgon Guvernatorit për dijeni një kopje të dokumentit të përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike, në rastin kur mbledhja e Komitetit nuk është drejtuar prej tij;
  - d) njofton departamentet e Bankës, në lidhje me zhvillimin e mbledhjes së Komitetit dhe në lidhje me çështjet jo konfidenciale të trajtuara gjatë saj;
  - e) arkivon në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Bankës, procesverbalin e mbledhjes, dokumentin e votimit të përgatitur sipas pikës 5, shkronja "h" të këtij neni, si edhe dokumentin e përgatitur sipas shkronjës "a" të kësaj pike;
  - f) me miratim të Komitetit, zbardh dhe dërgon pranë strukturave të tjera, brenda ose jashtë Bankës, konkluzionet përkatëse të mbledhjes së Komitetit, pas nënshkrimit të tyre nga Kryetari i Komitetit.
7. Krahas detyrave të përcaktuara në këtë nen dhe në përputhje me funksionin e tij në Komitet, sekretari kryen detyra të tjera që mund t'i caktohen nga Kryetari i Komitetit.

## **Kapitulli IV**

### **Votimi dhe konfidencialiteti**

#### **Neni 13**

#### **Votimi ne mbledhje**

1. Vendimet në Komitet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Abstenimet nuk lejohen.
2. Në rast të ndarjes së votave pro dhe kundër në mënyrë të barabartë, vota e drejtuesit të mbledhjes së Komitetit është përcaktuese.
3. Në votim marrin pjesë vetëm anëtarët, ndonëse në mbledhje mund të shfaqin mendimin e tyre të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.
4. Votimi është i detyrueshëm në rastet kur:
  - a) Komiteti i përcjell Këshillit Mbikëqyrës ose administratorëve të Bankës materiale të caktuara ose i propozon atyre miratimin e veprimeve të caktuara;
  - b) Komiteti propozon një qëndrim të caktuar të Bankës në marrëdhënie me palët e tjera për çështje të stabilitetit financiar;
  - c) kërkohet nga drejtuesi i mbledhjes.

## **Neni 14**

### **Ruajtja e konfidencialitetit**

1. Materialet, konkluzionet, rezultati i votimit dhe minutat e mbledhjes së Komitetit, përbëjnë informacion jopublik. Anëtarët e Komitetit dhe sekretari mbajnë përgjegjësi për trajtimin e tyre (administrimin e brendshëm, dërgimin tek palët e interesuara, publikimin) sipas përcaktimeve të kuadrit rregullativ përkatës.
2. Pavarësisht nga përcaktimi në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i Komitetit ka të drejtë të vendosë për lëshimin e tyre, të plotë ose të pjesshëm dhe në një formë të përshtatshme, ndaj palëve të tjera të interesuara, kur kjo nuk pengohet nga kërkesat e kuadrit rregullativ përkatës.

**KRYETAR I KESHILLIT MBIKEQYRES**

**Ardian FULLANI**